



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2294/3 Prot.

Tiranë, më 08.10.2025

VENDIM

Nr. 298, Datë 1.10.2025

**“PËR KOMANDIMIN E PROKURORIT ELSA MIHA SI INSPEKTOR PRANË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 1.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për komandimin e prokurorit Elsa Miha si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Referuar Opinionit nr. 2294, dt. 04.09.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i miratuar në datë 10.09.2025 nga Këshilli, pasi dëgjoi relatorin Ledina Riza si dhe diskutimet e zhvilluara në mbledhje plenare mbi çështjen,



V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim Këshilli*) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 225, datë 23.10.2024, "*Për plotësimin e një pozicioni si Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet procedurës së komandimit të prokurorëve*", Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës për plotësimin, përmes procedurës së komandimit, të një pozicioni si Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë prej 5 vitesh.
3. Në datë 28.10.2024, në faqen zyrtare të internetit të Këshillit është publikuar Njoftimi për shprehje interesi për komandimin e 1 (një) magjistrati prokuror si Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Njoftimi përmbante kriteret e kandidimit, dokumentacionin e nevojshëm, vendin dhe afatin për shprehjen e interesit. Kandidatët e interesuar duhet të dorëzonin aplikimin brenda datës 12.11.2024, ora 24.00 pranë Këshillit ose në adresën e e-mail karriera@klp.al.

Kriteret e kërkuara për këtë pozicion ishin që kandidatët:

- a) nuk shërbejnë në një pozicion me mandat të kufizuar;
 - b) kanë jo më pak se 13 vjet përvojë pune në funksionin e prokurorit;
 - c) nuk kanë masë disiplinore në fuqi;
 - d) janë vlerësuar "Shumë mirë" në dy vlerësimet e fundit;
 - e) nuk janë të komanduar në ndonjë pozicion tjetër.
4. Në vijim të njoftimit të mësipërm, me Shkresën nr. 2558 prot., datë 13.11.2024, prokurorja Elsa Miha ka paraqitur pranë Këshillit kërkesën për t'u emëruar Inspektore në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për këtë pozicion nuk ka patur kërkesa të tjera me shprehje interesi nga prokurorë të tjerë.
 5. Referuar nenit 54, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës duhet të përgatitë një Opinion lidhur me faktin nëse komandimi i kësaj kandidateje është në përputhje me interesat dhe mbarëvajtjen e punës në zyrën e prokurorisë ku ajo ushtron detyrën.
 6. Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se fillimisht, me Dekretin nr. 4349, datë 11.10.2004, të Presidentit të Republikës, znj. Elsa Miha është emëruar prokurore në stazh në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat. Më pas, me Dekretin nr. 4666, datë 03.10.2005, ajo është emëruar si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier. Me Dekretin nr. 9009, datë 25.03.2015, prokurorja Elsa Miha është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku ushtron edhe aktualisht detyrën.

7. Kandidatja Elsa Miha ka një eksperiencë profesionale prej më shumë se 20 vite, nuk shërben në një pozicion me mandat të kufizuar pasi aktualisht ushtron detyrën si prokurore në zyrën e Prokurorisë Tiranë, nuk ka masë disiplinore në fuqi si dhe nuk është e komanduar në një institucion tjetër. Në dy vlerësimet e fundit etike-profesionale, respektivisht për vitin 2016 dhe 2017-2019 është vlerësuar “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”.
8. Me Vendimin nr. 274, datë 23.12.2024, “Për verifikimin e kushteve ligjore të kandidimit për komandimin e 1 (një) prokurori në pozicionin e Inspektorit, pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka kualifikuar kandidaten Elsa Miha për këtë pozicion si dhe ka vendosur kryerjen e verifikimit të pasurisë dhe figurës, në përputhje me nenin 55, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
9. Me Vendimin nr. 8, datë 10.01.2025, “Për miratimin e Relacionit mbi fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidaten që ka kandiduar për t’u komanduar inspektore në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, znj. Elsa Miha dhe caktimin me short të relatorit për këtë procedurë verifikimi”, Këshilli ka filluar procedurën administrative për verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidaten Elsa Miha.

Në përfundim të këtij procesi, me Vendimin nr. 168, datë 11.07.2025, “Për përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të prokurorit Elsa Miha, kandidat për t’u komanduar inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka vlerësuar të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të prokurorit Elsa Miha, kandidat për t’u komanduar Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ka lejuar kandidaten të vijojë procedurën e mëtejshme të komandimit si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
10. Përpara përgatitjes së Opinionit përkatës, në lidhje me plotësimin e kriterit ligjor nëse komandimi është apo jo në përputhje me funksionalitetin apo mbarëvajtjen e punës së zyrës së prokurorisë ku kandidatja ushtron detyrën, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka kërkuar informacion zyrtar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në përgjigje, drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me e-mailin e datës 27.08.2025 ka informuar Këshillin, ndër të tjera se, “.....ne Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane, janë transferuar nga rrethet gjyqësore një numër i konsiderueshëm prokurorësh, të cilët shpresojmë të ndikojnë në uljen e ngarkesës dhe rritjen e cilësisë së hetimit. Megjithatë dhe nga procesi i rivlerësimit kemi patur përsëri largime këtë periudhë, shpresojmë që trendi i plotësimit të vendeve vakante nga ana e Këshillit të vazhdojë me të njëjtin ritëm. Për këtë arsye mendoj se dinamikat e lëvizjeve në Prokurorinë e Tiranës janë tepër aktive dhe largimi i një prokurori nuk e çënon funksionalitetin e zyrës në përgjithësi..”



11. Pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore për komandimin e prokurores Elsa Miha në pozicionin si Inspektor pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë prej 5 vitesh, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit miratimin e këtij Opinioni dhe vijimin e procedurave për komandimin e prokurores Elsa Miha në pozicionin e mësipërm.
12. Pas miratimit të këtij Opinioni në datë 10.09.2025 nga ana e Këshillit, në përputhje me nenin 54, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli njoftoi zyrtarisht Inspektorin e Lartë të Drejtësisë se, prokurorja Elsa Miha si kandidatja e vetme për këtë pozicion, përmbush kriteret ligjore për plotësimin e vendit vakant në fjalë.
13. Me Shkresën nr. 2520/2, datë 16.09.2025, “Kërkesë për komandimin e magjistratit”, drejtuar Këshillit (regjistruar me Nr. 2294/2, datë 18.09.2025), Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkoi komandimin e magjistrates Elsa Miha, si inspektore pranë kësaj zyre, për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.
14. Përsa më sipër, procedura administrative për komandimin e kandidates Elsa Miha në pozicionin vakant si më sipër konsiderohet e përfunduar dhe, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit, komandimin e prokurores Elsa Miha, si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenet 53, pika 2, 54, pika 4 dhe 55, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2 dhe 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Komandimin e znj. Elsa Miha, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në pozicionin si Inspektor pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Periudha e komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet duke filluar nga data 13.10.2025 deri në datën 13.10.2030.
3. Ky vendim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurorit Elsa Miha.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 1.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani



ZV/KRYETAR
Erind Germenji



ANËTAR
Sokol Stojani



ANËTAR
Zeqir Hoda



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Olger Eminaj



ANËTAR
Erind Merkuri



ANËTAR
Erion Fejzulla

